



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN

01 Nr. / Br. 112/20

Nr. i fq. / Br. sh. -1-

Data: / Datum 25.06.2020

VUSHTRISË - VUČITRAN



Republika e Kosovës


Kuvendi i Komunës-Vushtrri


Bazuar në nenin 12.1 dhe 40.2 "c" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, lidhur me nenin 20.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenin 40, paragrafi 2, pika (b) dhe nenin 41, paragrafi 2, pika (ç) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25 qershor 2020**, merr këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE 2021-2023

1. Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2021/01, e lëshuar nga Ministria e Financave, me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021-2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023 e Komunës së Vushtrrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit





REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRISË-OPSTINA VUČITRN

GI Nr./ Br 113/20

Nr. i fq./ Br. sh - 1 -

Data / Datum 25.06.2020

VUŠTRRI- VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, pika "d" në lidhje me nenin 73 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 41.2, pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrisë, nenit 8, paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më **25 qershor 2020**, mori këtë:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E PANELIT PËRZGJEDHËS PËR ANËTARËSIM NË
KOMITETET KONSULTATIVE**

1. Me këtë vendim formohet paneli përzgjedhës për anëtarësim në komitetet konsultative të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë në këtë përbërje:

- 1.1 Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit;
- 1.2 Faton Shabani, anëtar i kuvendit;
- 1.3 Agron Përçuku, anëtar i kuvendit;
- 1.4 Remzije Zekolli, zyrtare për Barazi Gjinore dhe
- 1.5 Isak Hyseni, nga shoqëria civile.

2. Paneli përzgjedhës i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të ketë për obligim intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, si dhe do t'i propozojë kuvendit listën me kandidatë për anëtarësim në komitetet konsultative.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: paneli i cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe Sekretaria e kuvendit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Nasuf Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

